

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), si dhe në bazë të njoftimit për përqendrim i parashtruar nga Lihtenshtajn Betajligungs GmbH (Liechtenstein Beteiligungs GmbH), me seli në Bankgase 9,1010 Vjenë, Austri (Bankgasse 9, 1010 Vienna, Austria), Menaxhmentkompetenc UBUnternehmensberatung GmbH (Managementkompetenz UB-Unternehmensberatung GmbH), me seli në Neptunveg 8, 9020 Kllagenfurt am Vortterzee, Austri (Neptunweg 8, 9020 Klagenfurtam Wörthersee, Austria) dhe RGA Betajligungs GmbH (RGA Beteiligungs GmbH), me seli nëKrotendorfershtrase 24,9073 Kllagenfurt-Fiktring, Austri (Krottendorferstraße 24, 9073Klagenfurt-Viktring, Austria), i dorëzuar nëpërmjet avokatit Martin Ivanov nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 30.03.2021, mori këtë:

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi i cili i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga Lihtenshtajn Betajligungs GmbH (Liechtenstein Beteiligungs GmbH), me seli në Bankgase 9,1010 Vjenë, Austri (Bankgasse 9, 1010 Vienna, Austria), Menaxhmentkompetenc UBUnternehmensberatung GmbH (Managementkompetenz UB-Unternehmensberatung GmbH), me seli në Neptunveg 8, 9020 Kllagenfurt am Vortterzee, Austri (Neptunweg 8, 9020 Klagenfurtam Wörthersee, Austria) dhe RGA Betajligungs GmbH (RGA Beteiligungs GmbH), me seli nëKrotendorfershtrase 24,9073 Kllagenfurt-Fiktring, Austri (Krottendorferstraße 24, 9073Klagenfurt-Viktring, Austria), mbi shoqërinë PV-Invest GmbH (PV-Invest GmbH), me seli në Lejksajd B07, 9020 Klagenfurt am Vortterzee, Austri (Lakeside B07, 9020 Klagenfurt am Wörthersee, Austria), edhe pse bie nën dispozitat e këtij ligji, është në përputhje me të njëjtin sepse nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose prishjen e konsiderueshme të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, veçanërisht si rezultat i krijimit ose përforcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në pajtim me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet të paguaj taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6 000,00 den. si dhe për Vendimin në shumën prej 30.000,00 den, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 и 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840.....03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, me datë 11.03.2021, dhe i plotësuar me 18.03.2021 dhe 19.03.2021, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtuftjeshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim për përqendrim nga Lihtenshtajn Betajligungs GmbH (Liechtenstein Beteiligungs GmbH), me seli në Bankgasse 9, 1010 Vjenë, Austri (Bankgasse 9, 1010 Vienna, Austria), Menaxhmentkompetenc UBUnternehmensberatung GmbH (Managementkompetenz UB-Unternehmensberatung GmbH), me seli në Neptunweg 8, 9020 Klagenfurt am Vortterzee, Austri (Neptunweg 8, 9020 Klagenfurt am Wörthersee, Austria) dhe RGA Betajligungs GmbH (RGA Beteiligungs GmbH), me seli në Krotendorferstrasse 24, 9073 Klagenfurt-Fiktring, Austri (Krotendorferstraße 24, 9073 Klagenfurt-Viktring, Austria), mbi shoqërinë PV- Invest GmbH (PV-Invest GmbH), me seli në Lejksajd B07, 9020 Klagenfurt am Vortterzee, Austri (Lakeside B07, 9020 Klagenfurt am Wörthersee, Austria).

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazë të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si në vijim:

Lihtenshtajn Betajligungs GmbH është pjesë e Grupit të Lihtenshtajnit ("LGrup", aktiv në sektorin e investimeve. LGrup investon në portofolin e saj të mjeteve, ose përmes rritjes organike ose përmes marrjeve të synuara. LGrup është aktiv në katër segmentet e mëposhtme të biznesit, prej të cilave segmenti i energjisë së rinovueshme është thelbësor në kontekstin e paraqitjes aktuale: (i) Bujqësia dhe ushqimi; (ii) Pylltaria; (iii) energjia rinovuese dhe (iv) Pasuria e patundshme

LGrup nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Menaxhmentkompetenc UB-Unternehmensberatung GmbH është një shoqëri holding dhe këshilluese me seli në Austri. Përveç aktiviteteve holding, Menaxhmentkompetenc UB-Unternehmensberatung GmbH ka një pjesë në PV-Invest dhe gjithashtu ofron shërbime këshillimi në fushën e energjisë së rinovueshme.

Menaxhmentkompetenc UB-Unternehmensberatung GmbH dhe shoqëritë e saj të lidhura nuk janë të pranishëm dhe nuk gjenerojnë qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

RGA Betajligungs GmbH është një kompani familjare holding dhe këshilluese me seli në Austri. Përveç aktiviteteve holding, RGA ka një pjesëmarrje në PV-Invest dhe gjithashtu ofron shërbime këshilluese në fushën e energjisë së rinovueshme (veçanërisht instalimet fotovoltaike).

RGA Betajligungs GmbH nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

PV-Invest është një ndërmarrje e përbashkët e Menaxhmentkompetenc UB-Unternehmensberatung GmbH dhe RGA Betajligungs GmbH dhe është aktive në zhvillimin, planifikimin, financimin, ndërtimin dhe funksionimin e termocentraleve diellore (fotovoltaike). Përveç kësaj, PVInvest ka katër hidrocentrale, të cilat përdoren gjithashtu për prodhimin e energjisë.

PV-Invest ka tre subjekte të regjistruara në Maqedoninë e Veriut: (i) PV-Invest Ballkani Perëndimor SHPK Shkup, (ii) Mega Solar SHPKNJP Shkup dhe (iii) Indigo Hidro Macedonia SHPK Shkup.

Aktivitetet e PV-Invest Group në Maqedoninë Veriore përfshijnë hidrocentrale të vogla dhe fotovoltaike. Grupi menaxhon impiantin PV Megasolar në rajonin e Novacit me kapacitet prej 999.0 kWp, i cili është i lidhur me rrjetin lokal të tensionit të mesëm prej 10 kV që përket furnizuesit maqedonas të energjisë elektrike EVN Maqedoni. Megasolar është PVsistem i montuar në toke me pjerresi fikse.

Në vitin 2019, PV-Invest Group filloi ndërtimin e një hidrocentrali me një kapacitet prej 1.8 MW afër Shkupit. Ka tre shtëpi elektrike. E para do të përfundojë muajin tjetër ndërsa i fundit në verën e këtij viti.

Përveç aktiviteteve të biznesit të përshkruara më lart, PV-Invest Group nuk ka aktivitete të tjera biznesi në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të përcaktojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës genësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjet juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritje të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Vladimir Naumovski